

VENDIM
Nr. 813, datë 31.12.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 23.4.2011, “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 9, e vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si vijon:

“9. Përgjashtimisht për vitin 2018, për institucionet e rivlerësimit të jepet një shpërblim në masën e përcaktuar, si më poshtë vijon:

a) Komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Komisionerët Publikë dhe gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit shpërblehen në masën e një page mujore bruto që përfshin pagën referuese bazë së bashku me shtesën për pagën në grup.

b) Këshilltarët ligjore dhe ekonomikë, sipas përkatësisë, shpërblehen në masën 80% të masës së shpërblimit sipas shkronjës “a”, të kësaj pike.

c) Nëpunësit e administratës shpërblehen përkatësisht në masën e vlerës së pagës për pozicion.

d) Punonjësit e tjerë të administratës shpërblehen përkatësisht në masën e vlerës së pagës për klasë.

Për efekt të këtij vendimi, përfitues të shpërblimit në masën e një page mujore bruto janë punonjësit që kanë punuar jo më pak se 12 muaj në institucion. Për punonjësit që kanë punuar jo më pak se 3 muaj në institucion, shpërblimi do të jetë i barabartë me gjysmën e pagës mujore bruto.”.

2. Efekti financiar i këtij vendimi përballohet nga fondi i veçantë i papërdorur nga ministritë dhe institucionet qendrore, për vitin 2018.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e përmendura në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama